



Prishtinë: 13.06.2018

Kodi i ZRRE-së: V\_994\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1795\_04\_18**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **21.05.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 13.06.2018, nxori këtë:

### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit H. R., nga Prishtina me shifër **DPR - 36963** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1795\_04\_18** i datës 23.04.2018.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 21.05.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Hajdin Rexhepi, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se njehsori i tij është njehsor dixhital dhe është i paprekshëm ashtu siç thuhet në refuzimin e ankesës. Në ankesë është theksuar se konsumatori nuk ka faj nëse njehsori nuk është në rregull dhe se punëtorët e autorizuar të KEDS-it është dashur që ta lajmërojnë për të ndërmarrë diçka. Konsumatori në ankesë ka theksuar se KEDS është dashur të reagojë e të ndërmarrë diçka e jo të hesht dhe tani ta ngarkojnë me vlera pasuhalle. Konsumatori gjithashtu ka theksuar se ai nuk do të paguaj dhe se pasi që konsumatorëve tjerë i është falur borxhi është e ndershme dhe morale t'i falet edhe atij kjo pjesë e borxhit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të konsumatorit të theksuara në ankesë, por që nuk ka vërtetuar me asnjë element se konsumatori është i dëmtuar me ngarkesën e bërë nga Departamenti i Faturimit i KESCO.

Bordi ka analizuar të gjitha konstatimet e theksuara nga shkalla e parë lidhur me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në procesverbalin e ndërrimit dhe heqjes e njehsorit



elektrik nr.0167152 të datës 20.08.2016, e në të cilën është larguar nga matja njehsorin elektrik nr.12734541 me gjendje TL=000008 kWh dhe TU=000003 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.16068174 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh dhe se në këtë procesverbal është theksuar se njehsori elektrik i konsumatorit duhet të dërgohet për shqyrtim në laboratorin e kalibrimit pasi që i janë kthyer kWh (kilovatorët) mbrapa.

Bordi ka analizuar edhe pikën tjetër të kundërshtimit në të cilën theksohet se njehsori është dixhital dhe i paprekshëm, dhe thekson se organi i shkallës së parë nuk ka theksuar se njehsori elektrik është i prekur, por ka theksuar se në punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit me datë 08.02.2016 kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nr.12734541, ku kanë konstatuar se: *“njehsori elektrik bllobat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka si dhe kanë konstatuar se gabimi në matje është -0.17%% kurse kanë evidentuar si vërejtje se: Njehsorit elektrik i është shfaqur në ekran (display) zilja, dhe në matjet impulsive njehsori është i saktë kurse në matjet në numëruar në momentin që ka ndërprerje të energjisë gjendja ristartohet, gjendja kthehet përsëri në zero FF. 004000000”*.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se KEDS [shtë dashur me vërejt dhe të merr masa për të rregulluar dhe jo ta ngarkoj paushall, Bordi i ZRRE-së ka theksuar se bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik kontestues nr.12734541 konstatohet se konsumatori nga periudha shkurt 2015 deri në periudhën gusht 2015 (data e ndërrimit të njehsorit 20.08.2015) është faturuar pa shpenzime të energjisë elektrike, përkatësisht është faturuar vetëm me taksa. Për shkak të mos faturimit të kësaj periudhe me shpenzime të energjisë elektrike, Departamenti i Faturimit në KESCO ka bërë korrigjimin plotësuese nr.84576DPR-36963 në vlerë **151.03€** për faturat e periudhës 03/2015 deri më 20.08.2015 duke ri faturuar faturat e asaj periudhe për shkak të mos matjes së saktë të njehsorit elektrik nr.12734541 me shpenzimet e periudhës së hershme 03/2014 - 08/2014. Bordi i ZRRE-së ka analizuar korrigjimin plotësues dhe ka konstatuar se ky korrigjimi plotësues është i drejt përkatësisht bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që për konsumatorët shtëpiak përfshin periudhën gjashtë mujore.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se atij nuk i është falur asnjë borxh sipas ligjit për faljen e borxheve të energjisë elektrike, Bordi i ZRRE-së thekson se Ligjin për Faljen e Borxheve Publike është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku neni 5 i këtij ligji i obligon të gjitha institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet publike për identifikimin dhe përgatitjen e listave të personave që përfitojnë nga falja e borxheve publike për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, si dhe neni 4 i këtij ligji janë të përshkruar edhe kriteret për tu plotësuar për faljen e borxheve. Andaj në rastin konkret ZRRE nuk është institucion i obliguar me këtë ligj që të bëjë faljen e asnjë borxhi publik tu e përfshirë edhe borxhin e energjisë elektrike. Për më tepër sipas dispozitës së lartcekur të gjithë përfituesit nga ky ligj duhet të i drejtojnë kërkesat e tyre pranë Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës (KEK), pasi që kjo ndërmarrje është e autorizuar me ligj ti kryej këto procedura. Duhet theksuar se konsumatori është ankuar për korrigjimin plotësues të bërë me datë 20.08.2015 dhe ka të bëjë me faturat e KESCO dhe jo me borxhin e KEK.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit H. R. dhe
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.